



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 25/2022 regjistër (JR)
Datë 03.06.2022

Nr. 64 i vendimit
Datë 16.12.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Mimoza Tasi	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 509, datë 17.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F, pika 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; nenet 1, 6, 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"; ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), shqyrtoi shkaqet

e ankimit dhe pretendimet e ngritura në parashtrime nga subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, e cila kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 509, datë 17.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë në tërësi,

VËREN:

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 3.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së¹, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarami është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 3.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, i ka përcjellë Komisionit raportin me shkresën nr. {***} prot., datë 05.07.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZh-së nr. {***}, datë 16.09.2021, në të cilin ka konstatuar papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Cufi.
 - 3.3. KLP-ja, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve që

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Edlira Cufi, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.

shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burime arkivore të KLP-së, i ka përcjellë Komisionit një raport² të hollësishëm dhe të arsyetuar për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Cufi.

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, pasi kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, për të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në pikat 1/c dhe 3 të nenit 58, pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 509, datë 17.02.2022, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në konkluzionet e mëposhtme.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreu IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm, pasi:

i) *Ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.*

ii) *Nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting” përdorimin e një automjeti për një periudhë 7-vjeçare, pa kundërshpërblim, të marrë nga një person i hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe vendimi i pushimit të hetimit ndaj tij është nënshkruar nga subjekti, në cilësinë e zëvendës drejtueses së kësaj prokurorie – dhe në pronësi të një shtetasi që ka rezultuar i proceduar për vepra penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016.*

4.2. Për kriterin e figurës, referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi:

i) *Duhet të kishte treguar kujdes të shtuar në lidhje me personat me të cilët ka udhëtuar jashtë vendit, me qëllim garantimin e besimit të publikut dhe shmangien e kontakteve me persona me precedentë penalë.*

ii) *Përdorimi pa shpërblim i një automjeti në pronësi të një personi të përfshirë në krimin e organizuar, pavarësisht se nuk u provua kontakti i drejtpërdrejtë i subjektit të rivlerësimit me të, është një shkelje etike e rëndë.*

4.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreut VI të ligjit nr. 84/2016:

i) *Subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në një mënyrë të pariparueshme nëpërmjet programeve të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje etike të rënda, si duke ushtruar funksionet në kushtet e konfliktit të interesit, ashtu edhe duke e përdorur atë.*

5. Kundër vendimit nr. 509, datë 17.02.2022, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, duke kërkuar përfundimisht nga Kolegji: (i) Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. (ii) Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese dhe atyre të parashikuara nga KEDNj-ja, ndaj saj. (iii) Ndryshimin e vendimit nr. 509, datë 17.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e saj në detyrë, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 13.9.2021, KLP-ja ka përcjellë pranë Komisionit “Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Edlira Cufi”.

II. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të këtij të fundit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Lidhur me formën e gjykimit të çështjes

6. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 509, datë 17.02.2022, bazuar në shkaqet e ngritura në ankim, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
7. Në fillim të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, trupi gjykues i Kolegjit analizoi shkaqet procedurale të ankimit, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor për korrigjimin e ndonjë shkeljeje të rëndë procedurale të kryer përgjatë hetimit administrativ në Komision, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet procedurale të ankimit

7.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se moscitimi i provave nga ana e Komisionit, e ka vënë atë në pamundësi të kontrollit të vendimmarrjes së tij. Nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi, trupi gjykues vëren se Komisioni ka përshkruar veprimet hetimore të

kryera, ka vlerësuar provat dhe shpjegimet e subjektit, si dhe i ka analizuar ato në raport me kërkesat ligjore, duke pasqyruar konkluzionet për secilën çështje. Fakti që subjekti i rivlerësimit është njoftuar nëpërmjet komunikimit të rezultateve paraprake të hetimit për çdo çështje apo gjetje të rezultuar nga hetimi, për të cilat ajo duhet të jepte shpjegime apo sillte prova, duke i kaluar formalisht barra e provës, në zbatim e kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, provon se Komisioni e ka realizuar detyrimin e tij si organ administrativ, në kuptim e zbatim të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative. Në çdo rast, ky vlerësim është tagër/diskrecional i Komisionit, në përputhje me atributet e hetimit dhe vlerësimit që ky organ ka në këtë proces rivlerësimi, sipas parashikimeve të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016.

7.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, duke mbajtur standard të dyfishtë në raste të ngjashme dhe duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në pozita diskriminuese, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk identifikoi rastet në të cilat është diskriminuar, si dhe nuk ka parashtruar në asnjë fazë të hetimit pretendime për veprime të Komisionit që përbëjnë trajtim të pabarabartë apo diskriminim të mundshëm të çdo lloji, në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës.

7.3. Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenet 13 dhe 14 të KEDNj-së dhe me nenin 1 të Protokollit 12 (shtesë)³, duke cenuar rëndë procesin e rregullt ligjor⁴, duke mos referuar ndonjë fakt ligjor, në mbështetje të pretendimit të saj. Nga shqyrtimi i ankimit, nuk rezulton që Komisioni të ketë shkelur të drejtat e mbrojtura nga neni 14 i KEDNj-së, përkundrazi, subjekti ka gëzuar garancitë e barazisë para ligjit të ofruara nga kjo dispozitë. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së⁵, si dhe në këndvështrimin parimor, përkundër nga sa ka pretenduar subjekti, nuk u provua ekzistenca e ndonjërit prej katër elementeve (neni 1 i protokollit) të nevojshme për të vlerësuar se ka ndodhur ndonjë shkelje. Trupi gjykues nuk ka konstatuar që subjekti të jetë diskriminuar për shkaqe përkatësie, në një të drejtë të shprehur apo të nënkuptuar, gjatë hetimit administrativ apo vendimmarrjes së Komisionit⁶.

³ Neni 1 i Protokollit 12 parashikon: “1. Gëzimi i të drejtave të mbrojtura me ligj do të sigurohet pa asnjë diskriminim mbi baza të tilla, si: përkatësia gjinore, raciale, ngjyre, gjuhe, besimi fetar, mendimi politik apo mendim tjetër, origjina etnike apo shoqërore, asocimi me një pakicë etnike, gjendjeje pasurore, lindjeje apo status tjetër. 2. Askush nuk do të diskriminohet nga asnjë entitet publik mbi bazat e përmendura në paragrafin 1”.

⁴ Subjekti ka referuar vendimi nr. 28/2014 të Gjykatës Kushtetuese.

⁵ “Savez crkava “Riječ života” dhe të tjerë kundër Kroacisë, par. 104-105; shih: “Udhëzim mbi nenin 14 të KEDNj-së” dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës, 31 dhjetor 2019: https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_14_Art_1_Protocol_12_ENG.pdf.

⁶ Po aty. § 22 i Raportit Shpjegues, ndër të tjera: “[...] gama e mbrojtjes që ofron ky nen u përket katër (4) kategorive të çështjeve, e në veçanti, “ku një individ është diskriminuar: 1. në gëzimin e një të drejte të njohur në mënyrë të shprehur një individ sipas ligjit vendas; 2. në gëzimin e një të drejte e cila mund të nënkuptohet nga një detyrim i shprehur i autoriteteve publike sipas ligjit të vendit, që nënkupton që një autoritet publik ka një detyrim në bazë të ligjit të vendit të sillet në një mënyrë të caktuar; 3. nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecionar; 4. nga ndonjë veprim ose mosveprim nga një autoritet publik [...]”.

7.4. Në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, për cenim të nenit 13 të KEDNj-së, ndonëse ajo nuk ka referuar se cila nga garancitë e ofruara për një zgjidhje efektive para një organi kombëtar është cenuar nga Komisioni, trupi gjykues sjell në vëmendje se garancitë e ofruara për një zgjidhje efektive të çdo shkeljeje të mundshme të Komisionit, të pretenduar prej saj, subjekti i rivlerësimit i gëzon nëpërmjet paraqitjes së ankimit në Kolegj. Ky arsyetim mbështetet në qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, ku, ndër të tjera, citohet se⁷: *Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelimit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera.*

7.5. Së fundmi, në kushtet kur subjekti nuk ka artikuluar në ankim se si procesi i hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, bazuar në dispozitat kushtetuese që krijuan bazën e procesit të rivlerësimit dhe ligji nr. 84/2016 ka përbërë diskriminim të ndonjë forme për të, është e pamundur të vlerësohet ky pretendim edhe në analogji të jurisprudencës së GjEDNj-së, kundrejt diferencës së trajtimit dhe justifikimit objektivisht për qëllime legjitime dhe në mënyrë proporcionale⁸. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti ka gëzuar të gjitha garancitë procedurale që lidhen me mundësinë për të dhënë shpjegime në përgjigje të pyetësorëve dhe rezultateve të hetimit, është njohur me aktet e dosjes gjyqësore të administruara kryesisht nga Komisioni, për të cilën ka nënshkruar dhe deklaratën⁹ e njohjes me dokumentacionin e administruar nga Komisioni, si dhe ka pasur kohën e mjaftueshme për të paraqitur shpjegimet e saj, akte shkresore/prova, në përgjigje të barrës së provës të kaluar nga Komisioni.

7.6. Në analizë të pretendimit të subjektit lidhur me defektet në përmbajtje dhe ato strukturore të vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se subjekti nuk ilustron në çfarë mënyre apo në cilën pjesë, vendimi i Komisionit bie ndesh me detyrimet ligjore dhe jurisprudenciale të formës dhe përmbajtjes, si dhe nuk ka ilustruar pretendimin me pjesë të arsytimit të vendimit, që sipas saj janë alogjike, apo që vijnë në kundërshtim me kërkesat e neneve 57 të ligjit nr. 84/2016 dhe 310 të Kodit të Procedurës Civile, të referuar nga subjekti.

7.7. Nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, sa i takon aspektit formal, trupi gjykues konstaton se vendimi i dhënë nga Komisioni, përmban të gjitha elementet e përcaktuara

⁷ Shih paragrafin 66 të vendimit nr. 2/2017, si dhe Opinionin e tij CDL-AD (2016)036, në paragrafin 63 të tij, ku Kolegji konsiderohet një juridiksion i specializuar që paraqet garanci gjyqësore për subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

⁸ § 49, Udhëzimi mbi nenin 14 të KEDNj-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës, faqe 15-19.

⁹ Në përmbajtje të deklaratës së nënshkruar prej subjektit më datë 31.01.2021, ora 10:30, evidentohet si vijon: “[...] pasi u njoha me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD) të dosjeve të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, deklaroj se [...] u njoha dhe mora të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana ime në CD [...]. Deklaroj se nuk kam asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin/materialet e tërhequra pranë Komisionit. Ky dokumentacion është konform me dokumentacionin e dosjeve që m’u vunë në dispozicion [...]”.

nga këto dispozita, referuar përcaktimeve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile. Për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me mënyrën e renditjes së çështjeve të trajtuara në vendim, krahasuar me mënyrën e renditjes së çështjeve në raportin e rezultateve të hetimit, trupi gjykues vlerëson se ky fakt nuk përbën shkelje procedurale dhe ligjore dhe nuk cenon vendimin e Komisionit, për rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar dhe i pakuptimtë. Ndërsa, sa i takon pretendimit të subjektit lidhur me arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerëson se arsyetimi i vendimit është detyrim ligjor, i cili në vetvete u tregon palëve/subjektit se është dëgjuar, kaluar barra e provës për çdo çështje të trajtuar në vendim, si dhe i jep mundësinë subjektit për ta kundërshtuar atë, nëpërmjet mjeteve të ankimit. Nga leximi i vendimit, vërehet se detyrimi për arsyetim është përmbushur nga Komisioni.

7.8. Subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, ka pretenduar se vendimi i dhënë nga Komisioni përmban gabime materiale, të cilat, sipas saj, tregojnë mungesën e kujdesit të duhur në përpilimin e vendimit, duke e ilustruar pretendimin me citimin në faqen nr. 14, paragrafi 8.8 i vendimit të Komisionit: “Në datën 30.2.2013, shtetasi A. H., me anë të kërkesës për regjistrim të mjetit rrugor, ka kërkuar të regjistrojë mjetin për herë të parë”. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues konstaton ekzistencën e gabimit material të referuar nga subjekti, e cila ka parashtruar se muaji shkurt, në aspektin kalendarik, nuk mund të ketë 30 ditë, por nuk e vlerëson në atë nivel sa të përbëjë shkak për cenimin e vendimit të Komisionit dhe aq më tepër të ndikojnë në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Bazuar në nenin 112, “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, të Kodit të Procedurave Administrative: “1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ”. Në këto kushte, gabimet materiale mund të korrigjohen kryesisht nga Komisioni ose me kërkesë të subjektit të rivlerësimit pa afektuar vendimarrjen përfundimtare kur zgjidhja në themel është e drejtë.

7.9. Lidhur me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni i ka kaluar barrën e provës në kundërshtim me përcaktimet ligjore, trupi gjykues çmon se Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar¹⁰, në të cilën detyrimet e subjektit të rivlerësimit për të siguruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij, janë konsoliduar si parime sa i takon garantimit të një procesi sa më objektiv. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, për procesin e rivlerësimit, i cili për nga natyra është një proces administrativ, në nenet A/1 dhe Ç/5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, qartësisht përcaktojnë se barrën e provës në këtë proces administrativ e ka subjekti i rivlerësimit.

7.10. Sa i takon pretendimit të subjektit për anashkalim nga ana e Komisionit të konkluzioneve të ILDKPKI-së, duke vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e cila kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe

¹⁰ Paragrafi 18.2 i vendimit nr. 28/2021, datë 27.09.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit A. V., paragrafi 40.1 i vendimit nr. 10/2019, datë 18.04.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Th..

pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin¹¹ tashmë të konsoliduar në vendimmarrjet e Kolegjit, sipas të cilit vlerësimi i kriterit të pasurisë dhe kriterit të kontrollit të figurës kryhet veçmas dhe mund të çojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për secilin kriter objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm.

7.11. Lidhur me pretendimin e subjektit se anëtarët e Komisionit nuk mund të bëjnë një vlerësim teknik në fushën e kontabilitetit, pasi këtë tagër ligji ua ka njohur specialistëve të fushës, trupi gjykues evidenton se në zbatim të nenit 22, pika 1 dhe nenit 23 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni dhe Kolegji, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, asistohen nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, të cilët zotërojnë njohuritë e duhura dhe ushtrojnë veprimtari këshilluese dhe ndihmëse, nëpërmjet studimit ekonomik/financiar të dosjes gjyqësore për çështjen, duke përgatitur relacionet përkatëse konform ligjit, që vlejnë/këshillojnë për të arritur në një vendimmarrje të drejtë edhe për çështje me natyrë financiare. Për rrjedhojë, trupi gjykues e konsideron këtë pretendim të subjektit të pabazuar.

7.12. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni ka aksesuar informacione në kundërshtim me përcaktimet e nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, duke mos i mundësuar subjektit të drejtën për t’u njohur me këto informacione, trupi gjykues i Kolegjit, pas shqyrtimit të akteve të administruara në fashikujt e Komisionit, konstaton si më poshtë.

7.12.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me kontrollin e figurës, është cituar se: *në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit, rezultuan se gjatë periudhës në të cilën znj. Cufi ushtronte detyrën si prokurorë, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, jemi informuar edhe mbi të dhëna që disponohen për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, grupi i punës, nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshoi konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi.*

7.12.2. Komisioni, në bashkëpunim me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, pati akses në informacionin e klasifikuar të poseduar nga institucionet verifikuese, për t’i studiuar ato, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishin arritur raportet e sipërpërmendura. Gjithashtu, Komisioni ka vlerësuar të arsyeshme të kryejë hetime të mëtejshme për verifikimin e disa çështjeve gjyqësore penale, duke zgjeruar hetimin në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit, duke administruar dhe dosje të tjera, përveç 5 dosjeve të përzgjedhura me short në bazë të nenit 41/4 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimeve, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me konstatimet e arritura nga DSIK-ja, si dhe ato të rezultuara nga hetimi i kryer nga vetë Komisioni.

¹¹ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 33, datë 29.07.2022, paragrafi 19, si dhe nr. 3, datë 06.02.2023, paragrafi 12.20.

7.12.3. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe barrën e provës së kaluar sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, përcjellë në Komision më datë 03.02.2022, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur pretendime apo kërkesa lidhur me dokumentacionin që i është vendosur në dispozicion nga Komisioni.

7.12.4. Po ashtu, edhe në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur ndonjë pretendim për arsytet apo indiciet për të cilat Komisioni po thellonte hetimin administrativ, duke adresuar pyetje në drejtim të problematikave të rezultuara gjatë hetimit lidhur me kriterin e figurës. Ky qëndrim dëshmon se subjekti nuk ka qenë e papërgatitur për shkaqet për të cilat hetimi administrativ po thellohej, por ka qenë e qartë për kufizimin e njohjes me dokumentacionin e klasifikuar, sipas parashikimeve ligjore që rregullojnë procedurën administrative. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se mosnjohja e subjektit me të dhënat e plota që pasqyrohen në informacionin e klasifikuar, përderisa ajo ka marrë dijeni nga seanca dëgjimore e zhvilluar në Komision, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, mbi rrethanat nga të cilat ka buruar informacioni dhe ka dhënë përgjigje për to sipas nevojave të saj për mbrojtje, nuk ka cenuar thelbin e të drejtave të saj për t'u mbrojtur, sipas vlerësimit të jurisprudencës së GjEDNj-së në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke*.

7.13. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, DSIK-ja dhe ONM-ja janë treguar paragjykes, pasi kanë shtrirë hetimin dhe kanë nxjerrë përfundime jashtë objektit të ligjit, lidhur me kontrollin e figurës, me qëllim dëmtimin e imazhit të saj si prokurore¹², përpos faktit që subjekti nuk paraqiti ndonjë provë në mbështetje të pretendimit të saj, trupi gjykues konstaton se nga shqyrtimi i akteve të fashikullit gjyqësor, Komisioni ka administruar nga DSIK-ja një raport të përditësuar, të deklasifikuar pjesërisht, ku ndër të tjera, citohet se: [...] *Gjatë periudhës në të cilën znj. Cufi ushtronte detyrën si prokurore, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, jemi informuar edhe mbi të dhëna që disponohen për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar*. Në vijim, Komisioni, në bashkëpunim me ONM-në, ka aksesuar në informacionin e klasifikuar të poseduar nga institucionet verifikuese dhe ka konstatuar kontakte, biseda telefonike etj., me disa shtetas, në lidhje me të cilët i ka kërkuar subjektit shpjegime¹³. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti rezulton të ketë konfirmuar vetëm njohjen me shtetasin L. K., lidhur me të cilin është shprehur se ka marrëdhënie krushqie.

7.14. Komisioni, në konsideratë edhe të shpjegimeve e deklarimeve të subjektit, vlerësimit tërësor të provave të rezultuara nga hetimi, ka arritur në konkluzionin se nuk rezultoi e provuar se shtetasi L. K. përfshihej në rrethin e personave, për të cilët subjekti

¹² Këtë pretendim, subjekti ua atribuon dyshimeve të ngritura nga Komisioni në lidhje me bashkëjetesën e saj me një person me precedentë penalë (informacion i përcjellë nga DSIK-ja në lidhje me shtetasin L. K.), për udhëtimet e kryera me persona me precedentë penalë (po nga DSIK-ja, në lidhje me shtetasin I. H.), si dhe për marrjen në përdorim të një automjeti në pronësi të një shtetasi që gjithashtu ka rezultuar me precedentë penalë (gjetje e referuar në Komision nga vëzhguesi ndërkombëtar, në lidhje me shtetasin A. H.).

¹³ Nëpërmjet pyetësorëve nr. 6 dhe 8.

i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit duke hetuar një çështje, në të cilën ka qenë i kallëzuar shtetasi L. K., ndërkohë që me këtë shtetas, subjekti ka pasur një lidhje krushqie. Ky konkluzion, duke qenë se nuk lidhet me vlerësimin e kontrollit të figurës, është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit të subjektit¹⁴.

7.15. Për sa është analizuar më sipër, por edhe nga vlerësimi në nivel parimor, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, nuk ka parashtruar fakte konkrete në lidhje me pretendimin e saj për paragjykim si më sipër përshkruar apo me pretendimin e saj për njëanshmëri të Komisionit në vendimmarrje, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka artikuluar ndonjë fakt apo provë në mbështetje të pretendimeve të saj. Për rrjedhojë, trupi gjykues nuk konstaton qëndrime apo veprime të Komisionit që do të ishin në kundërshtim me nenet D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës, apo me ligjin nr. 84/2016.

8. Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi shkaqet procedurale të ankimit, nuk identifikoi asnjë shkelje të rëndë ligjore dhe procedurale të kryer përgjatë hetimit administrativ të çështjes në Komision e, për rrjedhojë, çmon se debati gjyqësor është i panevojshëm sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte shkresore bashkëlidhur ankimit apo parashtrimeve, në kuadër të marrjes së tyre në cilësinë e provës, për konstatim të ndonjë situatë faktike ndryshe nga ajo e Komisionit, për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi që çështja të vijojë të shqyrtohet në dhomë këshillimi në bazë aktesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

C. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe shkaqet të ankimit

9. Komisioni, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreu IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm, pasi:
 - (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm;
 - (ii) nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* përdorimin e një automjeti për një periudhë 7-vjeçare, pa kundërshtpërblim, në pronësi të një shtetasi që ka rezultuar i proceduar për vepra penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016, i cili është hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, hetim i cili është pushuar me vendimin e pushimit

¹⁴ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me shkresën nr. {***}, datë 24.11.2021, ka bërë me dije për Komisionin se shtetasi L. K. rezulton i kallëzuar në procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 287, për të cilën nuk është regjistruar emër personi që i atribuohet vepra penale. Kjo çështje është në fazën e hetimeve dhe ky procedim penal po hetohet nga prokuroria Edlira Cufi, dhe për shkak të hetimeve që po kryhen në këtë dosje dhe ruajtjes së sekretit hetimor, nuk mund të dërgohen kopje të akteve të këtij procedimi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për këtë procedim.

të hetimit, të cilin e ka nënshkruar subjekti në cilësinë e zëvendës drejtueses së kësaj prokurorie.

10. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vendimin e Komisionit, sa i takon konkluzionit për pasaktësi në deklarimin e të ardhurave nga punësimi për periudhën e rivlerësimit 2003-2016, si dhe mosdeklarimin e depozitës së kursimit në Raiffeisen Bank ShA [në vijim “RFZ”] në vlerën 103.964 lekë, duke pretenduar se pasaktësitë nuk mund të përbëjnë shkak për penalizimin e saj, për sa kohë u provua me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i të ardhurave. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në kushtet kur institucionet verifikuese nuk gjetën të dhëna të rreme me qëllim fshehjen e pasurisë, ndaj saj nuk mund të aplikohet asnjë sanksion ligjor.

11. Trupi gjykues, në analizë të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar në dosje, konstaton se:

11.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar: (i) Paga për vitin dhe periudhën 1.10.2015 – 31.12.2015¹⁵ janë të ardhura bruto në vlerën 434.322 lekë dhe të ardhura neto në vlerën 263.348 lekë; (ii) depozitë kursimi në bankën RFZ, në vlerën 103.964 lekë, e krijuar në datën 1.10.2004, e maturuar në datën 1.8.2005, në vlerën 106.106,3 lekë¹⁶. Ndërsa në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri në përdorim apo pronësi të saj.

11.2. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhurat nga paga, si dhe depozitën e kursimeve në deklaratat periodike vjetore. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurat nga paga nuk i ka deklaruar të plota, në përputhje me periudhën e ushtrimit të funksionit të saj si prokurore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”). Ndonëse subjekti ka qenë e pasaktë në deklarim, trupi gjykues ka analizuar dokumentacionin e administruar dhe ka konstatuar që subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e depozitës së deklaruar në *vetting*, dhe të ardhurat e saj nga paga u morën në analizë sipas dokumentacionit të administruar, i cili provonte periudhën e saj të punësimit.

12. Lidhur me konkluzionin e Komisionit për mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting*, të përdorimit të automjetit tip “Volkswagen”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka pasur qëllim fshehjen e tij, por blerjen. Po ashtu, subjekti ka deklaruar gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, se gjatë periudhës së përdorimit ka paguar të gjitha taksat për këtë automjet. Subjekti ka pretenduar se ka qenë në pritje të kthimit të pronarit të automjetit nga shteti italian për të formalizuar shitblerjen e tij. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se: (i) Kodi Civil nuk parashikon ndonjë detyrim për përdorimin e një sendi me kundërshtpërblim; (ii) përdorimi i mjetit nga subjekti ka filluar pas regjistrimit të tij në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve

¹⁵ E pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, lidhur me periudhën e deklaruar, subjekti ka sqaruar se bëhet fjalë për të ardhurat e atij viti, pra ka qenë një lapsus periudha e cituar.

¹⁶ Shih rubrikën “Gjetje të tjera” në vendimin e Komisionit.

të Transportit Rrugor Shkodër në vitin 2013 (zhdoganuar në datën 26.07.2012); (iii) Kodi Rrugor (ndryshuar me ligjin nr. 10488, datë 05.12.2011) nuk e parashikon aktin e përdorimit si kërkesë ligjore.

13. Në analizë të pretendimeve të sipërpërmbledhura të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se, pavarësisht qëllimit të saj për ta blerë automjetin në një të ardhme të afërt, ose faktit se nuk dispononte akt përdorimi të tij, si dhe për sa kohë ky automjet ka qenë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit që nga viti 2013 dhe deri në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, në kuadër të këtij procesi, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të deklaronte saktësisht dhe plotësisht në deklaratën e pasurisë *vetting*, të drejtën e përdorimit të automjetit.
14. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se: (i) subjekti ka pasur në përdorim automjetin, së paku që nga viti 2013 (sikurse pretendon) e deri në vitin 2019 (kur ka nënshkruar kontratën e shitblerjes; (ii) automjeti është blerë me një çmim më të ulët nga sa subjekti kishte rënë fillimisht dakord me ndërmjetësin; (iii) subjekti i rivlerësimit ka miratuar vendimmarrjen për pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit/ndërmjetësit nga i cili kishte marrë automjetin në përdorim; (iv) subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë automjet në mënyrë të pandërprerë për rreth 7 vite, dhe pa kundërshtpërblim.

14.1. Në vlerësim të konstatimeve të mësipërme, ndërthurur edhe me qëndrimin tashmë të konsoliduar të jurisprudencës së Kolegjit në trajtimin e çështjeve të ngjashme¹⁷, trupi gjykues çmon se, nëse Komisioni do të kishte kryer një hetim të plotë të situatës faktike, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, do të mund të vlerësonte nëse do të ishin në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë/automjet.

15. Megjithatë, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë se vlerësimi i kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës e neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka përdorur për një periudhë të gjatë kohore, nga viti 2012 deri në vitin 2019, një automjet për të cilin nuk kishte tagra pronësie. Përdorimi i këtij automjeti nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2012, ndaj subjekti i rivlerësimit gjendet të paktën në kushtet e deklarimit të pasaktë, sipas nenit 33 pika 5, shkronja a e ligjit nr. 84/2016.
16. Problematikat e konstatuara lidhur me këtë kriter, ndonëse u gjetën të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u konsideruan nga trupi gjykues në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendime edhe në lidhje me rezultatin e analizës financiare të kryer nga Komisioni. Sipas kësaj analize, subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme

¹⁷ Shih vendimin nr. 21, datë 10.09.2020 (JR).

në masën (-) 2.754.791 lekë. Kjo balancë negative, sipas subjektit, rezulton për shkak se analiza e kryer nga Komisioni është kryer veçmas për secilin vit. Po ashtu, pretendon se diferencat pozitive të viteve 2003, 2004, 2005, 2006, duhet të konsideroheshin në analizë si gjendje *cash*.

17. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka deklaruar vlerën e likuiditeteve *cash* në banesë apo brenda sistemit bankar, në DIPPV, duke filluar që nga viti 2003, dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, sikurse kërkojnë përcaktimet e ligjit nr. 9049/2003. Për më tepër, Kolegji, në jurisprudencën e tij, është shprehur se deklaratat e interesave privatë periodikë janë prova e vetme mbi të cilën provohet ekzistenca e një pasurie, siç janë likuiditetet *cash*. Nuk mund të pranohet ekzistenca e likuiditeteve *cash* të cilat nuk janë deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe as nuk mund të prezumohet përdorimi i tyre si burim i ligjshëm për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit.
18. Një tjetër shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, është se Komisioni nuk i ka kërkuar të provojë me dokumentacion ligjor disponibilitetin financiar të të afërmeve/motrës së saj, për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit për subjektin e rivlerësimit dhe prindërit e saj.

18.1. Për t'i dhënë përgjigje shkakut të ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se rrethanat e prezantuara nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të pretendimit se udhëtimet për periudhën 2005-2016, janë mbuluar nga motra e saj, duken të arsyeshme e bindëse nëse mbahet në konsideratë marrëdhënia e ngushtë familjare prind-fëmijë, qëndrimet afatgjata të tyre në vendin ku jeton një prej fëmijëve, siç rezulton nga aktet në fashikull, mosha e avancuar e prindërve dhe, mbi të gjitha, fakti që detyrimet ndaj prindërve pritet që të mbulohen nga gjithë fëmijët dhe prezumimi që i mban vetëm subjekti i rivlerësimit do të ishte i paarsyeshëm dhe i padrejtë si shpenzim kryekëput i vetë asaj. Për më tepër, në kushtet kur destinacioni i vetëm i udhëtimeve të tyre ka qenë Italia, dhe qëndrimi me periudha të gjata, e bëjnë të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se prindërit e saj kanë udhëtuar për te vajza e tyre dhe shpenzimet e udhëtimit të tyre janë mbuluar prej motrës së subjektit. Për këtë arsye, ndryshe nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se, në rrethanat konkrete të faktit, pretendimi i subjektit është bindës. Për rrjedhojë, shpenzimet e udhëtimit konsiderohen të mbuluara nga motra e subjektit të rivlerësimit.

18.2. Gjithashtu, konstatojmë se në analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, shpenzimet e udhëtimit zënë peshën më të madhe të shpenzimeve të subjektit, konkretisht 67% të totalit të tyre, dhe mungesa e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar në shumën (-) 2.754.791 lekë. Në rastin në gjykim, kjo diferencë negative reduktohet në vlerën (-) 380.434 lekë. Në vijim të vlerësimit të kryer sipas arsyetimit të referuar më sipër, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin si më poshtë vijon.

i. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni, konstaton se për periudhën 2003 - 2016, duke përllogaritur shpenzimet e udhëtimit në Itali, si të mbuluara prej motrës së subjektit të rivlerësimit, sipas pretendimit të subjektit, sërish do të rezultonte një

mungesë e burimeve financiare të ligjshme sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka përdorur për një periudhë të gjatë kohore, nga viti 2012 deri në vitin 2019, një automjet për të cilin nuk kishte tagra pronësie, duke mos e deklaruar këtë automjet, as në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë, sipas nenit 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016.

19. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se problematikat e konstatuara lidhur me kriterin e pasurisë, ndonëse u gjetën të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u konsideruan nga trupi gjykues në një vlerësim tërësor dhe të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Ç. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me kriterin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit dhe shkaqet e ankimit

20. Komisioni, lidhur me këtë kriter, ka arritur në përfundim se:
- Subjekti duhet të kishte treguar kujdes të shtuar për personat me të cilët ka udhëtuar jashtë vendit, me qëllim garantimin e besimit të publikut dhe shmangien e kontakteve me persona me precedentë penalë.
 - Përdorimi nga subjekti pa shpërblim i një automjeti në pronësi të një personi të përfshirë më krimin e organizuar, është një shkelje etike e rëndë, e cila do të vlerësohet së bashku me konkluzionet e nxjerra gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, por nuk rezultoi e provuar dijenia dhe kontakti i drejtpërdrejtë i subjektit të rivlerësimit me të.
21. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka administruar nga DSIK-ja raportin e datës 09.02.2021, të deklasifikuar plotësisht, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin është konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, znj. Edlira Cufi. Në vijim, pas kërkesës së Komisionit për përditësim informacioni, DSIK-ja ka dërguar raportin e datës 16.9.2021, deklasifikuar pjesërisht, ku ndër të tjera, citohet se: "[...] Gjatë periudhës në të cilën znj. Cufi ushtronte detyrën si prokurore, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, jemi informuar edhe mbi të dhëna që disponohen për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar". Në përfundim, grupi i punës, nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, për shkak se subjekti ka rezultuar të ketë pasur kontakte me shtetasit B. P., M. P., A. Sh. dhe I. H..

21.1. Në vijim, Komisioni, në bashkëpunim me ONM-në, ka aksesuar informacionin e klasifikuar të poseduar nga institucionet verifikuese, për ta studiuar, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishte arritur grupi i punës në DSIK, në raportet e sipërpërmendura. Po ashtu, Komisioni i është drejtuar edhe subjektit të

rivlerësimit¹⁸, duke i kërkuar të shpjegonte shpeshhtësinë e kontakteve, rrethanat e njohjes dhe për të përshkruar lidhjen me këta shtetas. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti ka konfirmuar vetëm njohjen me shtetasit L. K. dhe I. H..

21.2. Në përfundim të hetimeve, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk rezultoi e provuar se shtetasi L. K., për të cilin subjektit i ishin kërkuar shpjegime dhe ishin kryer hetime, të përfshihej në rrethin e personave për të cilët subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte, pasi nuk kishin rezultuar kontakte mes subjektit dhe këtij shtetasi. Megjithatë, sikurse do të analizohet në vijim, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka hetuar një çështje në të cilën ka qenë i kallëzuar shtetasi L. K., me të cilin subjekti ka lidhje krushqie¹⁹.

21.3. Në lidhje me udhëtimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit me shtetasin I. H., Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdes të shtuar, me qëllim garantimin e besimit të publikut dhe shmangien e kontakteve me persona me precedentë penalë. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti është shprehur se ka udhëtuar me mjete të rastit, dhe nuk ka qenë në dijeni të faktit se pronarët e tyre kanë qenë me precedentë penalë. Në përfundim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *Nuk rezultoi e provuar që subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte jorastësore me shtetasin I. H., që të sillnin detyrimin e subjektit për të deklaruar në shtojcën e deklaratës “vetting” si kontakt me një person të papërshtatshëm, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.*

22. Trupi gjykues konstaton se konkluzioni i mësipërm i Komisionit i referohet një udhëtimi të kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 25.05.2008, nën shoqërinë e shtetasit I. H. dhe bashkëshortes së tij. Ndaj këtij shtetasi, ka rezultuar të jetë regjistruar procedimi penal me nr. {***/2018, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, i cili është pushuar me anë të vendimit 11.04.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe procedimi penal me nr. {***/2019, për të njëjtën veprë si më sipër, i cili është pushuar me vendimin nr. {***}, datë 26.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

22.1. Në analizë të kësaj situate faktike, trupi gjykues vlerëson se një konkluzion i tillë i përgjithësuar, është përveçse i paqartë, po aq edhe jorelevant në konsideratë të rrethanave dhe specifikave të fakteve në rastin konkret. Ky konstatim mbështetet në të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, sipas të cilave konstatohet se, së pari, bëhet fjalë vetëm për një udhëtim, dhe së dyti, ky udhëtim është kryer në vitin 2008, ndërsa shtetasi I. H. ka rezultuar subjekt i një procedimi penal të regjistruar në vitin 2018. Në këto kushte, gjendet i paqartë dhe i paargumentuar/bazuar, konkluzioni i Komisionit se subjekti ka treguar mungesë kujdesi në kontaktet me persona me

¹⁸ Nëpërmjet pyetësorëve nr. 6 dhe 8.

¹⁹ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me shkresën nr. {***}, datë 24.11.2021, ka bërë me dije për Komisionin se shtetasi L. K. rezulton i kallëzuar në procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 287, për të cilën nuk është regjistruar emër personi që i atribuohet vepra penale. Kjo çështje është në fazën e hetimeve dhe ky procedim penal është në fazën e hetimeve dhe po hetohet nga prokurorë Edlira Cufi, dhe për shkak të hetimit që po kryhet në këtë dosje dhe ruajtjes së sekretit hetimor, nuk mund të dërgohen kopje të akteve të këtij procedimi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për këtë procedim.

precedentë penalë, për sa kohë, në momentin e kryerjes së udhëtimit nga subjekti, shtetasi I. H. nuk kishte statusin e personit në procedim penal.

22.1.1. Në lidhje me pronarin e automjetit që subjekti ka pasur në përdorim, shtetasin A. H., Komisioni ka arritur në konstatimin se nuk u provua dijenia dhe kontakti i drejtpërdrejtë i subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas, si dhe se përdorimi nga subjekti i rivlerësimit pa shpërblim i një automjeti në pronësi të një personi të përfshirë më krimin e organizuar, është një shkelje etike e rëndë.

22.1.2. Subjekti i rivlerësimit, si gjatë procesit të rivlerësimit, ashtu edhe në ankimin e depozituar në Kolegj, ka pretenduar se nuk ka pasur asnjëherë dijeni nëse ky shtetas ka qenë i dënuar, dhe se personalisht nuk ka kryer asnjë veprim hetimor ndaj tij, fakt i provuar dhe nga informacioni i përcjellë nga prokuroria.

22.1.3. Trupi gjykues konstaton se në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës, bazuar në nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, në Komision, është paraqitur gjetja nr. {***} prot., datë 07.01.2022²⁰, nga vëzhguesi ndërkombëtar, lidhur me shtetasin A. H., pronari i automjetit që subjekti ka marrë në përdorim në vitin 2012 dhe që e ka blerë në vitin 2019. Në këtë gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar parashtron të dhënat gjyqësore të këtij shtetasi [A. H.] dhe faktin që rezulton i dënuar²¹ disa herë nga gjykatat italiane²², për vepra të cilat bëjnë pjesë në gamën e veprave penale të parashikuara në pikat 8 dhe 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave personi cilësohet i përfshirë në krimin e organizuar.

22.1.4. Sipas gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, shtetasi A. H. rezulton pronari i automjetit, i cili gjatë vitit 2012 i është dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit, me anë të ndërmjetësimit të shtetasit A. H.. Asnjë shpërblim financiar nuk i është dhënë nga subjekti i rivlerësimit pronarit të automjetit A. H. për përdorimin e automjetit prej shumë vitesh, që më pas është blerë nga subjekti në vitin 2019 kundrejt çmimit 2.000 euro. Në këtë gjetje, vëzhguesi ka rekomanduar për të vlerësuar: (i) plotësinë e deklaratës për kontrollin e figurës, si dhe ekzistencën e kontakteve direkte/indirekte të subjekteve të rivlerësimit me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (ii) përshtatshmërinë etike të sjelljes së subjektit të rivlerësimit që konsiston në marrjen në përdorim të automjetit në pronësi të një personi të përfshirë në krimin e organizuar.

23. Në përfundim të hetimeve, si dhe në vlerësim të shpjegimeve të subjektit pas kalimit të barrës së provës, lidhur me sa rekomandohej nga ONM-ja, Komisioni ka arritur në përfundimin se nuk rezultoi e provuar dijenia e subjektit Edlira Cufi për dënimin penal të shtetasit A. H., pronar i automjetit të përdorur prej saj dhe, për pasojë, nuk konstatoi mangësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, si dhe ekzistencën e kontakteve direkte/indirekte të subjektit të rivlerësimit me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Komisioni ka çmuar se në rastin konkret, subjekti gjendej në kushtet e

²⁰ Protokolluar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 7.1.2022.

²¹ Me gjetjen përcillet dhe certifikata e dëshmisë së penalitetit nga Ministria e Drejtësisë së Italisë, me nr. {***}, në emër të shtetasit A./N. H..

²² Dënuar më datë 19.11.2002, datë 17.06.2003, datë 28.04.2006, datë 18.02.2008, datë 25.02.2009, datë 11.02.2010, datë 17.12.2010, për veprën penale të mbajtjes, importimit, transportimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, si dhe ka marrë disa dënime për vepra të tjera penale, si: “Shfrytëzim i prostitucionit” dhe “Migram i paligjshëm”.

papërshtatshmërisë etike të sjelljes, që konsiston në marrjen në përdorim të automjetit në pronësi të një personi të përfshirë në krimin e organizuar.

23.1. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, me pretendimin se tendenca e tij për të referuar shtetasit A. H. dhe A. H. si i njëjti person, është dashakeqëse dhe në kufijtë e një absurditeti juridik. Sipas subjektit, në vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni ka ngatërruar pronarin legjitim të mjetit, me shtetasin të cilit i ishte lënë në administrim ky mjet.

23.2. Trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit pasi, sikurse do të analizohet edhe në vijim, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, hetimi dhe konstatimet e Komisionit në lidhje me shtetasit A. H. dhe A. H., janë krejtësisht të ndryshme.

24. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti ka krijuar e mbajtur kontakte jorastësore me persona me precedentë penalë, apo të cilët kanë pasur probleme me ligjin e janë proceduar brenda dhe jashtë vendit. Njëri prej tyre, nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar të jetë proceduar penalisht në Itali për vepra të krimit të organizuar në vitin 2011 dhe hetuar edhe në Shqipëri në vitin 2019.
25. Po ashtu, parë në tërësi me marrëdhëniet e tjera të interesit dhe ato shoqërore që subjekti ka pranuar të ketë krijuar me këta persona, të shtrira në kohë, sikurse ajo që deduktohet nga përdorimi i automjetit pa kundërshtpërblim për shtatë vite, dhe blerja e tij me një vlerë sa $\frac{1}{2}$ e çmimit, dëshmon se sjellja e treguar nga subjekti është në mospërputhje me standardet e pritshme nga publiku për një funksionare të drejtësisë. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe ndjekjen e çështjeve penale nga subjekti në cilësinë e prokurores për procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, për veprën penale: "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga neni 287 (në ngarkim të L. K.) apo procedimin penal me nr. {***} të vitit 2017, për veprën penale të "Vjedhjes", parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, që ka nisur me kallëzimin e shtetasit F. D., sikurse edhe me ndërthurjen e interesave të saj pasurorë, për përdorimin e automjetit në pronësi të shtetasit A. H., menjëherë pasi personi i cili administronte mjetin (A. H.) ishte hetuar dhe pushuar procedimi penal prej prokurorisë, edhe me miratimin e subjektit të rivlerësimit.
26. Trupi gjykues arrin në përfundimin se problematikat e konstatuara lidhur me këtë kriter, ndonëse u gjetën të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti ka kontakte të papërshtatshme sipas nenit 61, pika 2, apo se gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u konsideruan në një vlerësim tërësor dhe të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

D. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe shkaqet e ankimit

27. Në analizë të vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, ka arritur në konkluzionin se:

(i) Subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje etike të rënda, si duke ushtruar funksionet në kushtet e konfliktit të interesit, ashtu edhe duke e përdorur atë, duke arritur në përfundimin se subjekti, me veprimtarinë e saj, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në një mënyrë të pariparueshme nëpërmjet programeve të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës.

28. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se nuk ka pasur dijeni mbi faktin se pronari i mjetit në përdorim prej saj, rezultonte me precedentë penalë, si dhe ka mohuar të ketë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me këtë shtetas. Po ashtu, subjekti ka parashtruar në ankim se nuk kishte dijeni se vendimi i miratuar prej saj, i atribuohet shtetasit prej të cilit kishte marrë automjetin në përdorim.

28.1. Nga verifikimi i dosjes së automjetit me targë {***}, i markës “Volkswagen”²³, ka rezultuar se ky mjet është zhdoganuar në datën 26.07.2012 dhe është regjistruar në datën 30.07.2012, në emër të shtetasit A. H.. Pjesë e kësaj dosjeje është edhe fatura e lëshuar nga shoqëria “{***}”, në Itali, e datës 21.12.2012, për shitjen e automjetit në vlerën 400 euro, shtetasit A. H.. Referuar informacionit të përcjellë nga Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare²⁴, është konstatuar se subjekti ka rezultuar përdorues i këtij mjeti, në vitet 2015, 2016, 2017, 2018, ndërkohë që pronar rezultonte shtetasi A. H..

28.2. Përdorimi i këtij automjeti është deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit standard²⁵, ku është shprehur se rreth vitit 2012 ka përdorur mjetin me targë {***}, në pronësi të shtetasit A. H., të cilin më pas e ka blerë²⁶. Në vijim, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti është shprehur se mjetin në fjalë e ka marrë në një pikë shitjeje automjetesh, në pronësi të shtetasit A. H., të cilit pronari ia kishte lënë për ta shitur. Arsyeja e mosdeklarimit në DVP-në e vitit 2012, nga ana e saj, ka qenë fakti se subjekti nuk dispononte akt përdorimi për këtë mjet.

28.3. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, lidhur me mosdeklarimin e përdorimit të këtij automjeti. Në vlerësim të Komisionit, subjekti duhet të shpjegonte nëse fakti që një prokuror merr në përdorim për një periudhë 7-vjeçare, pa kundërshtpërblim, një automjet pa titull pronësie, është veprim që cenon figurën e magjistratit dhe etikën në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 103, germat “ç” dhe “d” të tij, si dhe të shpjegonte se nëse fakti i përfitimit dhe përdorimit të mjetit me targë {***}, pothuaj një muaj pasi janë mbyllur hetimet për procedimin penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasit A. H., përbën konflikt interesi, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrim të funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9637/2005”).

²³ Përcjellë pranë Komisionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën nr. {***} prot., datë 21.12.2021.

²⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 15.12.2020.

²⁵ Përgjigje e pyetjes nr. 8, në pyetësin standard.

²⁶ Automjeti është blerë me kontratën me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.07.2019, në vlerën 2000 euro. Në përmbajtjen e kontratës citohet se likuidimi i çmimit është bërë jashtë zyrës noteriale.

28.4. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se mjeti në fjalë është marrë me qëllimin për t'u blerë dhe në fund është finalizuar me një kontratë shitblerjeje. Sipas subjektit, dispozitat e Kodit Civil nuk parashikojnë përdorimin e sendit me kundërshtpërblim. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se ndryshimet e fundit në Kodin Rrugor²⁷ nuk e kanë të parashikuar aktin e përdorimit të mjetit si kërkesë ligjore. Ky mjet ka hyrë në qarkullimin civil në datën 30.2.2013 dhe, për më tepër, mjeti nuk ka qenë në Shqipëri në kohën e nënshkrimit të vendimit të pushimit ndaj shtetasit A. H..

28.5. Trupi gjykues vëren se, lidhur me përdorimin e automjetit, në vendim, Komisioni nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore. Ndërsa, për sa i përket saktësisë që subjekti ka bërë në lidhje me momentin e fillimit të përdorimit të këtij automjeti, trupi gjykues konstaton se, në arritjen e konkluzionit se subjekti ka pasur në përdorim një automjet për një periudhë shtatëvjeçare, Komisioni u është referuar deklarimeve të subjektit në pyetësorët nr. 1 dhe 2, ku vetë ajo është shprehur se fillimi i përdorimit të automjetit prej saj ka qenë rreth vitit 2012.

28.6. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk është provuar në asnjë dokument shkresor që pronari i pikës së shitjes së mjeteve (shtetasi A. H. ose B. Ll.) të jetë hetuar apo dënuar ndonjëherë nga autoritetet ligjzbatuese të shtetit italian dhe aq më pak i përfshirë në krimin e organizuar. Sipas subjektit, konfuzioni i mësipërm i Komisionit vijon më tej, kur vlerëson se subjekti në marrëdhënien me shtetasin A. H., gjendej në kushtet e konfliktit të interesit. Ajo ka sqaruar se nënshkrimi i vendimit të pushimit të çështjes ndaj shtetasit A. H., nga ana e saj, është kryer në kuadër të ushtrimit të kompetencave administrative në funksionin që ajo kryente si zëvendës drejtuese e prokurorisë, dhe në asnjë rast nuk ka hetuar shtetasin në fjalë, sikurse ka rezultuar e provuar edhe nga hetimi i kryer nga Komisioni.

Në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesave, në kuptim të ligjit nr. 9637/2005, apo kushteve të parashikuara nga nenet 26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti është shprehur se nuk është gjendur në situatat e përcaktuara nga këto dispozita, pasi nuk ka hetuar çështjen në fjalë, por vetëm ka sigluar vendimin e pushimit dhe shkresat në cilësinë e zëvendës drejtueses. Për sa i përket marrëdhënies me shtetasin A. H., subjekti, si në përgjigje të pyetësorëve, ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore kur është pyetur nga trupi gjykues i Komisionit, si dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, është shprehur se me këtë shtetas, nuk ka pasur asnjë marrëdhënie njohjeje, shoqërore apo familjare²⁸, nuk ka hetuar ndonjë procedim penal në ngarkim të tij, por e njeh përpara vitit 2012, pasi kishte shkuar pranë pikës së tij të shitjes së automjeteve, me qëllim për të blerë një automjet.

28.7. Subjekti është shprehur se pas disa bisedimeve, shtetasi A. H.²⁹ i kishte sugjeruar mjetin tip “Golf” në vlerën 4.000 euro, që një i njohuri i tij ia kishte lënë për ta shitur. Pas

²⁷ Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 178/1, germa b, ndryshuar me ligjin nr. 10488, datë 05.12.2011, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 3878, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor në Republikën e Shqipërisë”.

²⁸ Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3.

²⁹ Në deklaratimet e saj, subjekti është shprehur se këtë shtetas e njohte si “B. Ll.”, dhe se pas negociatave për çmimin, duke marrë parasysh se mjeti pas 7 viteve përdorim, ishte amortizuar, është arritur marrëveshja që ajo të paguante 2000 euro për blerjen e tij në vitin 2019.

dakordësimit në lidhje me çmimin e shitjes, subjekti e ka marrë këtë mjet në përdorim, në mirëbesim. Referuar dosjes së këtij mjeti, çmimi i paguar prej subjektit sipas kontratës së shitjes në vitin 2019, ka qenë 2000 euro.

28.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të çështjes objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se gjatë procesit të rivlerësimit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër³⁰ ka informuar Komisionin se në ngarkim të shtetasit A. H., ishte regjistruar procedimi penal me nr. {***} i vitit 2012, për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, i hetuar nga një tjetër prokurorë, e cila më datë 15.06.2012, ka marrë vendimin për pushimin e çështjes. Nga studimi akteve të procedimit penal nr. {***}/2012, ka rezultuar sa vijon.

28.9. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal mbi bazën e materialeve të ardhura nga Drejtoria e Policisë Shkodër për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a/1 i Kodit Penal. Nga aktet e këtij procedimi, ka rezultuar se sipas informacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja, automjeti tip “Peugeot 206”, pa targë, është sekuestruar më datë 20.02.2012, pasi ka rezultuar pozitiv (i vjedhur), me shënimin {***} të Interpolit. Në momentin e sekuestrimit, ky automjet ka qenë në posedim të shtetasit A. H.. Prokurorja e çështjes ka kryer veprimet hetimore lidhur me ngjarjen, ku ndër të tjera ka thirrur dhe ka marrë në pyetje shtetasin A. H., i cili ka deklaruar se mjetin në fjalë e ka blerë në Itali.

28.10. Nga këqyrja dhe marrja me procesverbal e dy fletëve të printuara nga sistemi {***} të Interpolit, ka rezultuar se ky mjet ka rezultuar i vjedhur më datë 30.01.2012, në Itali³¹. Ndërsa, sipas akt ekspertimit teknik nr. {***}, të datës 23.03.2012, nuk kanë rezultuar ndërhyrje mekanike apo konture të karaktereve të mëparshme, në numrin e shasisë së mjetit. Bashkëlidhur akteve të procedimit penal nr. {***}/2012, është përcjellë edhe dokumenti i verifikimit në sistemin {***} të Interpolit më datë 30.05.2012, mjeti “Peugeot 206”, ngjyrë blu, pa targë, me numër shasie {***}, i cili rezulton negativ³².

28.11. Në përfundim të hetimeve me vendimin e datës 15.06.2012, prokurorja e çështjes ka vendosur: “Pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2012”. Në faqen e fundit të këtij vendimi, gjendet një shënim me shkrim dore: zëvendësdujtuese Edlira Cufi dhe nënshkrimi i saj³³.

28.12. Në analizë të sa më sipër, referuar dokumentacionit të administruar nga hetimi dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 6, në të cilin ka deklaruar se nga

³⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 07.07.2021.

³¹ Referuar procesverbalit të datës 20.02.2012, në faqen 16 të procedimit penal nr. {***} të vitit 2012, konstatohet se mungon fleta me detajet e vjedhjes së mjetit, sikurse është edhe data 10.01.2010, që citon si oficeri i policisë gjyqësore, po ashtu edhe prokurorja F. L. në vendimin e pushimit.

³² Gjithashtu, bashkëlidhur ka rezultuar dokumentacioni, si: i) certifikatë pronësie në emër të shoqërisë {***}, e cila mban datën 21.12.2011 të çregjistrimit për eksport, si dhe vulën e Degës së Doganës Durrës dhe datën 28.12.2012, bashkëlidhur së cilës gjendet versioni i përkthyer dhe njësuar; (ii) faturë shitje mjeti në vlerën 400 euro, e datës 21.12.2012, lëshuar nga shoqëria {***}; (iii) leje qarkullimi provizore me nr. {***} prot., datë 09.01.2012, në emër të z. A. H.; (iv) deklaratë doganore e datës 09.01.2012, sipas së cilës është paguar shuma 12.502 lekë.

³³ Faqe 4 e procedimit penal nr. {***} të vitit 2012.

viti 2008 - 2013 ka qenë zëvendës drejtuese e Prokurorisë Shkodër, Komisioni ka konkluduar se dijenia mbi procedimin penal në ngarkim të shtetasit A. H. gëzon statusin e fakteve të njohura në kuptim të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Faktet e njohura për Komisionin, ose faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji, nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”.

28.13. Nga hetimi i Komisionit, rezultoi se njohja e ndërsjellë dhe kontakti me shtetasin A. H. kanë qenë edhe përgjatë periudhës së kryerjes së hetimeve të procedimit penal nr. {***}/2012. Në deklaratën e shtetasit A. H., citohet se: “[...] Unë i nënshkruari A. H., i njohur ndryshe si B. Ll., prej mbi 10 vitesh ushtroj aktivitetin tregtar të shitblerjes së automjeteve. Rreth vitit 2012, me sa kujtoj, pranë ambientit tim tregtar ka ardhur shtetasi A. H., të cilin unë e njoh me emrin N., dhe më ka lënë për të shitur një mjet, të cilin e kishte sjellë nga Italia, duke më kërkuar që t’ia shes. Pas disa kohësh, në ambientin tim tregtar u paraqit shtetasja Edlira Cufi, e cila kërkonte të blinte një mjet ekonomik se i duhej për punë. Shtetasja në fjalë kishte ardhur dhe më parë për të blerë një mjet, por nuk kishte pëlqyer asnjë. Herën e fundit që erdhi, në momentin që pa mjetin që kishte lënë shtetasi A. H., i pëlqeu mjeti dhe çmimi, dhe më tha që donte ta blinte këtë mjet dhe kërkoi të bënim menjëherë dokumentacionin përkatës, pasi ishte prokurore dhe nuk donte të kishte probleme me ligjin apo me persona të tjerë. Duke qenë se pronari i mjetit ishte larguar duke ma lënë mjetin në mirëbesim, pasi e njihja dhe kisha raporte shoqërore, por duke mos më lënë asnjë tagër me shkrim që ta shisja apo ta jepja me qira, këtë mjet ia kam dhënë shtetasës në fjalë, pa i marrë asnjë vlerë, duke i bërë me dije se në momentin që do të paraqitej shitësi, do ta njoftoja në mënyrë që të bëhej kontrata e shitjes direkt mes palëve, si dhe likuidimi i çmimit. Për këtë fakt, kam njoftuar edhe mikun tim, shitësin A. H., duke i thënë që kur të kishte mundësi të vinte në Shqipëri, të më bënte me dije, pasi ia kisha shitur mjetin dhe të njoftoja edhe blerësin që të bënin dokumentacionin e nevojshëm, si dhe pagesën”.

- 29.** Në lidhje me nënshkrimin e vendimit të pushimit të çështjes penale ndaj shtetasit A. H., gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka pretenduar se në kohën kur hetohej shtetasi në fjalë, Prokuroria Shkodër funksiononte me dy linja, pra drejtuesi i prokurorisë dhe dy zëvendës drejtues. Secili zëvendës kishte prokurorët e tij, dhe roli i tyre konsistonte vetëm në siglimin e vendimeve, ndërsa kompetencën për shfuqizimin e kishte vetëm drejtuesi i prokurorisë. Sipas rastit, nëse konstatoheshin problematika, në fund të dosjes bëhej shënimi përkatës dhe dosja kalonte te drejtuesi. Në rastin konkret, sipas subjektit, nuk ka pasur problematika lidhur me hetimet e kryera nga prokurorja e çështjes.

29.1. Referuar praktikës së mjetit, të përcjellë në Komision nga DPSHTRr-ja, konstatohet gjithashtu se subjekti edhe pse nuk deklaroi datë të marrjes së mjetit në përdorim në vitin 2012, mjeti i markës Volkswagen, me targë {***}, vit prodhimi 2001, është zhdoganuar më datë 26.07.2012, datë e cila është pothuajse dy muaj më vonë se data 30.05.2012, datë e pushimit të procedimit penal nr. {***}/2012, në ngarkim të shtetasit A. H..

29.2. Në konkluzion të sa më sipër, Komisioni, referuar dokumentacionit në dosjen penale, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti mbi pozicionin e saj si zëvendës drejtuese e Prokurorisë Shkodër në vitin 2012, konstaton se subjekti i rivlerësimit, në ushtrim të kompetencave të saj, në zbatim të urdhrit nr. 148, datë

09.05.2008, “Për caktimin e shkallës së hierarkisë në prokurori”, ka “miratuar” vendimin e pushimit të datës 15.06.2012 të procedimit nr. {***}/2012, në ngarkim të shtetasit A. H.. Ky urdhër përcakton se shkalla e hierarkisë në prokurori përcaktohet sipas niveleve të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë. Sipas pikës 4.1 të tij, *prokurori më i lartë, i ndihmuar nga prokurorët pranë tij, i delegon kompetencat për të vendosur ndryshimin ose shfuqizimin e akteve prokurorit më të ulët në hetimet paraprake, si vendime mosfillimi të procedimit penal, pezullimi të hetimit ose pushimi të çështjes/akuzës [...]*.

29.3. Komisioni, në analizë të provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe deklarimeve të subjektit gjatë seancës dëgjimore, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, në cilësinë e saj si prokurore, duke marrë në përdorim një automjet për 7 vjet, pa kundërshtim, nga një person i cili ka qenë subjekt i një procedimi penal, i hetuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe i miratuar prej saj në cilësinë e zëvendës drejtueses së prokurorisë, ka vepruar në kundërshtim me: (i) ligjin nr. 9367/2005; (ii) nenet 26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale; (iii) urdhrin nr. 141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, ku parashikohet, ndër të tjera, se: “Prokurorët duhet të garantojnë zbatimin e rregullave që përcaktojnë parimet, normat, duke shmangur konfliktin e interesit”; (iv) urdhrin nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”.

29.4. Komisioni, në vendim ka bashkuar faktin e marrjes në përdorim të automjetit, me situatën e konfliktit në dukje të interesit, në miratimin e vendimit të pushimit, dhe ka vlerësuar se tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit tregon një raport të tillë të përkujdesjes së subjektit të rivlerësimit me zbatimin e ligjit, të papranueshëm për të gëzuar besimin e publikut.

30. Në lidhje me vlerësimin e gjendjes së konfliktit të interesit, në konsideratë edhe të përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të gjendjes Civile³⁴, sipas së cilës shtetasi A. H. nuk ka rezultuar të ketë përdorur gjeneralitete të tjera, sikurse ka pretenduar subjekti, trupi gjykues vlerëson se duket alogjik pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se nuk ishte në dijeni të identitetit të personit nga i cili kishte marrë automjetin në përdorim për 7 vjet, për sa kohë bëhet fjalë për një tregtar mjetesh që operonte në treg për rreth 10 vite (pranë të cilit subjekti është paraqitur disa herë, për të blerë një automjet), në qytetin në të cilin subjekti ka jetuar gjithë jetën, si dhe ka ushtruar detyrën e prokurores.

30.1. Në këto kushte, veprimet e subjektit të rivlerësimit duken sikur komprometojnë sjelljen e prokurorit, duke krijuar perceptimin e përfitimeve për shkak të detyrës dhe nuk justifikojnë shkujdesjen e veprimeve të saj për marrjen në përdorim të një automjeti në pronësi të një tjetër shtetasi, i cili nuk ishte prezent në atë moment, e për më tepër mbajtjen e tij për disa vite pa bërë ndonjë përpjekje për të formalizuar marrëdhënien e përdorimit.

30.2. Në vlerësim të kësaj situatë, trupi gjykues mban në konsideratë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit, të cilat përbëhen nga tërësia e parimeve, normave dhe rregullave gjerësisht të pranueshme, të cilat udhëheqin sjelljen e prokurorit gjatë

³⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 09.07.2021.

ushtrimit të detyrës, gjatë kryerjes së veprimtarisë jashtë funksionit, si dhe në jetën private. Këto standarde synojnë të vendosin, ruajnë dhe forcojnë integritetin profesional dhe personal të prokurorëve, si dhe të rrisin efektivitetin, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre, në emër dhe në interes të shoqërisë, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale. Këto rregulla përkrahin zbatimin e standardeve më të larta të sjelljes etike dhe profesionale, ruajtjen e imazhit të profesionistit, si dhe sjelljen e përshtatshme në zyrë, në prokurori, në gjykatë apo jashtë këtyre ambienteve, për shkak të funksionit si prokuror.

30.3. Në këndvështrim të sa më sipër, përdorimi i automjetit për shtatë vite pa kundërshtpërblim, duke mos kryer asnjë përpjekje në drejtim të formalizimit të marrëdhënies së përdorimit, e për më tepër në kushtet kur pronari i këtij automjeti ka rezultuar me precedentë penalë, në vlerësim të trupit gjykues nuk i përgjigjet pritshmërisë për standardin e sjelljes së prokurorit. Gjithashtu, trupi gjykues mban në konsideratë se rëndësia e sjelljes së prokurorit dhe ndikimi i saj në besimin e publikut te sistemi i drejtësisë është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri, Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, sipas të cilave shkelja e ligjit nga një prokuror jo vetëm dëmton reputacionin e funksionit si prokuror, por inkurajon mosrespektimin e ligjit dhe cenon besimin e publikut në integritetin e sistemit të drejtësisë, në kushtet kur sjellja e prokurorit duhet të ishte e denjë dhe të mos ngriheshin perceptime favorizimi apo përfitimesh për shkak të pozicionit, në sytë e publikut. Në këtë optikë, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht përgjegjësisë profesionale gjatë ushtrimit të detyrës nëpërmjet vendimeve të marra prej saj, qoftë edhe në kuadër të veprimtarisë organizative, sikurse subjekti pretendon, edhe sjellja e saj jashtë zyrës zë një vend po aq të rëndësishëm. Konkretisht, ky fakt ka marrë rëndësinë e një vlere themelore të magjistratit dhe gjen vend në nenin 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, sipas së cilës sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

30.4. Në ushtrim të funksionit të saj si zëvendësdrejtuese e Prokurorisë Shkodër në periudhën hetimeve të procedimit penal nr. {***/2012, në ngarkim të shtetasit A. H., subjekti ka “miratuar” vendimin e pushimit të procedimit penal nr.{***/2012. Gjithashtu, përgjatë kohës së hetimit të këtij procedimi, subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte me shtetasin A. H. e në përfundim të hetimeve, me pushimin e procedimit pas datës 15.06.2012, ka marrë në përdorim pa shpërblim mjetin në pikën e shitjes në pronësi të shtetasit A. H..

30.5. Në kuadër të vlerësimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, e cila kundërshton konkluzionin e Komisionit duke parashtruar se nuk ka qenë në kushtet e heqjes dorë nga procedimi, pasi nuk ka qenë prokurorja që ka hetuar çështjen, por ka nënshkruar vendimin në cilësinë e zëvendësdrejtueses, trupi gjykues çmon t’i referohet ligjit të kohës nr. 9102, datë 10.07.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Konkretisht, pikës 4.1 të urdhrit nr. 148, datë 09.05.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për caktimin e shkallës së hierarkisë në prokurori”.

30.6. Në eventualitetin e fakteve, si dhe në frymën e kuadrit ligjor rregullator të evidentuar më sipër, duket se pretendimi i subjektit se në procedimin penal ndaj shtetasit A. H., ka pasur vetëm kompetenca formale në kuadër të veprimtarisë organizative të prokurorisë, nuk qëndron. Trupi gjykues konstaton se subjekti gëzonte statusin dhe rolin e prokurorit më të lartë, çka legjitimonte ushtrimin e kompetencave kontrolluese nëpërmjet ndryshimit apo shfuqizimit të vendimit të prokurorit të çështjes, në kuptim të përcaktimeve të mësipërme.

30.7. Nga analizimi i situatës faktike më sipër, nën dritën e fakteve që një procedim penal është pushuar dhe ka vijuar marrëdhënia e subjektit me shtetasin A. H., edhe në vitin 2019, duke formalizuar kontratën e shitjes së automjetit, në vlerësim të trupit gjykues, nënshkrimi i vendimit nga subjekti mund të shmangej, për sa kohë në Prokurorinë e Shkodrës, në atë periudhë, përveç subjektit, ushtronte funksionin e zëvendës drejtuesit edhe një tjetër prokuror. Fakti që subjekti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim, duket se kompromenton besueshmërinë e veprimeve të saj dhe të krijon përshtypjen se subjekti është paraqitur para pikës së shitjes së mjeteve, pasi procedimi penal ishte pushuar, dhe ka zhvilluar negociata si për përdorimin e automjetit, ashtu edhe për çmimin e tij.

30.8. Trupi gjykues konstaton se rrethanat në të cilat, sipas deklarimit të subjektit, është marrë në përdorim automjeti prej saj, dëshmojnë për një sjellje të shtetasit A. H. në favor të subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, si prokurore dhe zëvendës drejtuese e Prokurorisë, që krijojnë perceptimin e përfitimit të një favorit në mënyrë të parregullt dhe në dukje të një situate të konfliktit të interesit.

- 31.** Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit për hetim në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak se me të dëmtuarin akuzues, në procedimin penal nr. {***}, viti 2017, për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, shtetasin F. D.³⁵, subjekti kishte kryer një udhëtim dy vite³⁶ pas pezullimit të hetimit të çështjes së kallëzuar prej tij, dhe dërgimin e dosjes në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër për vijimin e hetimeve, për zbulimin e autorit të veprës penale.
- 32.** Trupi gjykues vëren se, në vendimin e Komisionit, ndër të tjera, vërehet se subjekti i rivlerësimit në hetimin mbi kallëzimin e shtetasit F. D., ka ushtruar funksionet në kushtet e konfliktit të interesit në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 5, “Interesat privatë”, pika 1, në të cilën përcaktohet se: “Interesat privatë të zyrtarit janë ato interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhënie të njohura të miqësisë apo të armiqësisë”.
- 33.** Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se gjendja e konfliktit të interesit në hetimin e një çështjeje në vitin 2017, nuk mund t’i atribuohet një udhëtimi të kryer nga subjekti me shtetasin i cili ka qenë në cilësinë e të dëmtuarit akuzues në këtë proces, rreth

³⁵ Subjekti ka deklaruar se shtetasi F. D. është djali i kolegut të saj, i cili është punonjës policie.

³⁶ Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer një udhëtim në datën 31.08.2019, me këtë shtetas.

dy vite më pas, pra në vitin 2019. Megjithatë, frekuentimi/udhëtimi i subjektit me shtetas të cilët kanë qenë palë në çështje të hetuara prej saj, në vlerësim të trupit gjykues, afekton etikën e saj si prokurore.

34. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti gjendej në kushtet e konfliktit të interesit në gjykimin e çështjes ku i kallëzuar ishte shtetasi L. K., trupi gjykues konstaton sa vijon.

34.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka informuar Komisionin se shtetasi L. K. ka rezultuar i kallëzuar në procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287, për të cilën nuk ka të regjistruar emër personi që i atribuohet vepra penale, dhe se ky procedim penal është duke u hetuar nga prokurore Edlira Cufi. Në këto kushte³⁷, duke qenë se shtetasi L. K. kishte ende statusin e personit të kallëzuar, dhe jo person nën hetim, për sa kohë subjekti kishte lidhje krushqie me këtë shtetas, duhet të merrte masa në drejtim të shmangies së çdo perceptimi të mundshëm në sytë e publikut, lidhur me paanësinë e saj në ushtrimin e detyrës si prokurore, në hetimin e çështjes ku ky shtetas rezultonte i kallëzuar.

35. Trupi gjykues vëren se mungesa e kujdesit nga subjekti, ndaj parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj, evidentohet jo vetëm në lidhje me çështjen ku i kallëzuar ka qenë shtetasi L. K., por edhe në rastin kur ka hetuar kallëzimin e bërë nga shtetasi F. D. dhe më pas ka kryer një udhëtim me të, si dhe në rastin kur ka nënshkruar vendimin e pushimit të hetimit ndaj shtetasit A. H., e më pas ka marrë mjetin në përdorim prej tij. Në eventualitetin e këtyre fakteve, trupi gjykues, në konsideratë të parimit se drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por edhe duhet të shihet, vlerëson me rëndësi faktin se subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, ka kryer shkelje të rënda të etikës në ushtrimin e detyrës së prokurores, në kuadër të përmbushjes së detyrës së saj.
36. Neni 10 i ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me çështjen e etikës parashikon se: “Prokurorët duhet të ruajnë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre dhe të sillen në mënyrë profesionale, në përputhje me ligjin dhe rregullat e etikës”.
37. Neni 3, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton vlerat themelore që duhet të ketë një individ, që ushtron funksionet e magjistratit. Sipas kësaj dispozite, një magjistrat (prokuror) duhet të demonstrojë vlerat personale bazuar në vetëdijen që sjellja e një magjistrati ndikon në imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut. Në kuadër të parashtrimit të vlerave themelore, kjo dispozitë parashtron edhe disa standarde të sjelljes dhe mënyrën si një magjistrat duhet të ushtrojë funksionin, rregulla që vlejné si gjatë ushtrimit të funksionit, edhe jashtë tij. Në kuadrin e forcimit të besimit të publikut, paragrafi 5 i nenit 3 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendos disa rregulla orientuese dhe detyruese për sjelljen e magjistratit në ushtrimin e

³⁷ Deri në datën 10.11.2021, kur është kthyer përgjigje nga Prokuroria Shkodër, me shkresën nr. {***} prot., çështja ishte ende duke u hetuar.

funksionit. Ndër të tjera, përcaktohet edhe se funksioni i magjistratit duhet të ushtrohet në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vetëdije për rëndësinë e të gjitha detyrave dhe përgjegjësi që janë ngarkuar me ligj, si dhe për pasojat që çdo sjellje e tij ka te sistemi i prokurorisë, por edhe te zhvillimi i shoqërisë në tërësi.

38. Po kështu, neni 4, pika 2, shkronja “b” e ligjit të sipërcituar, përcakton se: “Magjistrati duhet të shmangë çdo sjellje të papërshtatshme dhe që bie në kundërshtim me ligjin apo me vetë etikën, si dhe duhet të marrë të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor”. Në optikën e këtyre përcaktimeve ligjore, trupi gjykues arrin në përfundimin se konstatimet e përshkruara dhe analizuar më sipër, lidhur me subjektin e rivlerësimit, duhet të vlerësohen në tërësi në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
39. Në përfundim të sa është analizuar më sipër lidhur me kriterin e vlerësimit profesional, trupi gjykues konstaton se:
- i. Subjekti i rivlerësimit ka përdorur për një periudhë të gjatë kohore, pa kundërshtpërblim, një automjet të marrë nga një person i cili ka qenë i proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për veprën penale të “Trafikimit të mjeteve motorike”, e cila është pushuar me vendim nga prokuroria dhe është miratuar nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e zv./drejtueses së kësaj prokurorie, hetim i cili duket se është zhvilluar gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit kishte kontakte me këtë person. Këto fakte e vendosin subjektin në kushtet e një sjelljeje që vlerësohet nga trupi gjykues si një konflikt në dukje interesi dhe në shkelje të etikës të magjistratit.
 - ii. Gjithashtu, fakti që subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë shtetit me një person dhe me automjetin e tij, për të cilin ka ndjekur një kallëzim penal, vlerësohet nga trupi gjykues si një sjellje e cila cenon po ashtu etikën e magjistratit.
 - iii. Problematikat e konstatuara lidhur me këtë kriter, ndonëse u gjetën të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti është i papërshtatshëm për të vijuar ushtrimin e detyrës në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, u konsideruan nga trupi gjykues në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit 84/2016.
 - iv. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në bazë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, në një vlerësim të përgjithshëm, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
40. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, ka kryer shkelje të rënda të etikës në ushtrimin e detyrës së prokurores, në një mënyrë të pariparueshme nëpërmjet programeve të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës, edhe për shkak të natyrës së këtyre shkeljeve, duke u gjendur në këtë mënyrë në kushtet e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.
41. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi nr. 509, datë 17.02.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Cufi, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 509, datë 17.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Cufi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 16.12.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Mimoza TASI

nënshkrimi